**AKT- THEMELIMI**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"ROAA COMPANY" SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"ROAA COMPANY" Sh.p.k.**

1- MOHAMED GAMALELDIN TAWFIQ AHMED,atesia GAMALELDIN shtetas Egjiptian , lindur me 13.02.1990 ne CAIRO , identifikohet nepermjet pasaportes A17276063

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë "**ROAA COMPANY**" Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1**
**FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise eshte **"ROAA COMPANY" Sh.p.k.**,

**NENI 2**
**BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI3**
**SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "GLAUKIA" Lagja 17,Brenda Ambienteve te Tregut Industrial, Durres, Shqiperi.
Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.
Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

Mohamed

## NENI 4
## KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

## NENI 5
## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "**ROAA COMPANY**" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie të konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive ne Republiken e Shqiperise dhe ne territoret e tjera dhe ka si objekt të veprimtarise së saj:

**5.1** PUNIME NE FUSHEN E NDERTIMIT .

Me qëllim arritjen e objektit të saj, shoqëria me vendim të organit kompetent, mund të zotëroje në mënyre të drejtpërdrejte apo të tërthortë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, shqiptare apo të huaja, të aktiviteteve te ndryshme. Pjesmarrja në shoqëri që për llojin e tyre nuk ofrojne përgjegjësi të kufizuar, miratohet paraprakisht nga asambleja e ortakeve.

## NENI 6
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndare në 1 pjese.Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

**1.** MOHAMED GAMALELDIN TAWFIQ AHMED **100,00%**

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

## NENI 7
## AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.



Mohamed

## NENI 8
## ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**ROAA COMPANY**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator të shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare është emeruar ENXHI ALI .

## NENI 9
## DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane,19/01/2020**

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE**
**"ROAA COMPANY" SH.P.K.**

MOHAMED GAMALELDIN TAWFIQ AHMED



Mohamed

Enxhi Ali